

[Data 14/11/2023]

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - mall**

*(investim edhe mirëmbajtje)*

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Zhvillimi dhe Rritja e Kapaciteteve të Infrastrukturës për Ofrimin e Shërbimit Wifi në Ambjentet Publike të Tiranës”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
32424000-1**

**Vlera e Fondit Limit: 12,500,000 (dymbëdhjetë milion e pesëqind mijë) Lekë pa TVSH,** i përbërë nga dy vlera që u përkasin dy llogarive të ndryshme, respektivisht llogarisë për investime dhe asaj për shpenzime korrente, si më poshtë vijon:

1. “Zhvillimi dhe Rritja e Kapaciteteve të Infrastrukturës për Ofrimin e Shërbimit Wifi në Ambjentet Publike të Tiranës” në programin buxhetor “Investim (231)” me tipologji “Hardware + Software + Punime civile” me vlerë të fondit limit 10,000,000 (Dhjetë milion) lekë pa TVSH.
2. “Zhvillimi dhe Rritja e Kapaciteteve të Infrastrukturës për Ofrimin e Shërbimit Wifi në Ambjentet Publike të Tiranës” në programin buxhetor “Shpenzime operative (602)” me tipologji “Mirëmbajtje” me vlerë të fondit limit 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.

*Shënim: Referuar rekomandimit nr. 6911 prot., datë 28.10.2020 të APP-së, vlerat e ofertës ekonomike të investimit dhe të mirëmbajtjes të ofruara nga operatorët ekonomikë nuk duhet të tejkalojnë vlerën e fondit limit të parashikuar në njoftimin e kontratës për këto zëra (investim edhe mirëmbajtje), pasi në të kundërt oferta do të konsiderohet si ofertë e dhënë mbi fond limit dhe si e tillë, nuk mund të kualifikohet.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për*

*Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

*Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

*Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

*.... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;”. Kjo procedurë është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.*

*Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare është jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

**2.2.2** Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2020, 2021, 2022), të paraqitur në autoritetet përkatëse, Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt-Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

**2.2.3** Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.*

*Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

## **2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:**

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave, shërbimeve të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave, shërbimeve të furnizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

*Duke marrë parasysh faktin se pjesë e rëndësishme e kësaj kontrate përveç furnizim e implementim i pajisjeve të infrastrukturës janë dhe shërbime të tjera përvec “vendosjes” dhe “instalimit” si ai i Shërbimit të mirëmbajtjes e suportit, AK gjykon se si pjesë të përvojës së mëparshme duhet të gjykojë dhe mbi **shërbime** të ngjashme me shërbimet objekt kontrate, pjesë e preventivit të publikuar dhe pjesë e rëndësishme e kontratës objekt prokurimi, për një periudhë kohore prej 24 (njëzet e katër) muaj, sikurse është përcaktuar qartë dhe në Njoftimin e shkurtuar të Kontratës cituar dhe në DST, Seksionin 2/ paragrafi 2.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës.*

*Përfshirja e këtyre zërave si pjesë të shërbimeve të ngjashme të realizuara garanton AK se Operatori Ekonomik do të përmbush me sukses jo vetëm zërat e furnizimit të pajisjeve por dhe shërbimeve të mirëmbajtjes objekt kontrate.*

*Operatorët Ekonomik pjesëmarrës në procedurë, duhet të dëshmojnë përvojën e mëparshme të realizuar për mallrat dhe shërbimet duke respektuar ndarjen sipas zërave buxhetorë të përcaktuar dhe në Njoftimin e Shkurtuar të Kontratës (investim edhe mirëmbajtje).*

**2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standardin ISO 9001 (ose ekuivalente), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit,

i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).*

**2.3.3.** Operatori ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me standardin ISO 20000-1 (ose ekuivalente) për sistemin e menaxhimit të shërbimit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).*

**2.3.4.** Operatori ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me standardin ISO 27001 (ose ekuivalente), për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).*

#### **Argumentimi 2.3.2, 2.3.3 dhe 2.3.4**

*Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,*

*...“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”*

*si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:*

*... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”*

**2.3.2 ISO 9001** (ose ekuivalente) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

*Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.*

**2.3.3 Standardi ISO 20000-1 (ose ekuivalente)** përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohen në teknologjitë e informacionit.

*ISO 20000-1 ose ekuivalente është një kuadër standardizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomike për: ndjekjen konsistente të shërbimeve përgjatë afatit të zbatimit të kontratës.*

*Kjo certifikatë ose ekuivalente e saj, siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha shërbimet që do të realizohen përgjatë kontratës, do të menaxhohen sipas standardeve më të mira të shërbimeve të teknologjisë së informacionit.*

**2.3.4 ISO 27001** është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :

- mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.

*Referuar sa më sipër cituar, kjo kërkesë është e lidhur ngushtësisht me zërat si më poshtë vijon, objekt kontrate:*

- *Mirëmbajtje e pajisjeve, infrastrukturës dhe të gjithë komponentëve ekzistues të cituara në këtë dokument (dokumenti i termave të referencës) dhe pajisjeve, infrastrukturës dhe komponentëve të reja që do të implementohen nëpërmjet kësaj kontrate, për një periudhë 24 (njëzetë e katër) muaj.*
- *Shkëmbimi i të dhënave duhet të zhvillohet brenda një infrastrukture të sigurt dhe të mbrojtur nga ndërhyrjet e mundshme duke siguruar mbrojtjen e të dhënave, moslejimin i aksesit të pasigurtë në rrjetin e të dhënave etj.*

*Për realizimin e kërkesave si më sipër por jo vetëm, certifikimi ISO 27001 (ose ekuivalente) i operatorit ekonomik është një garanci e nevojshme për Autoritetin Kontraktor për aplikimin e praktikave mbi menaxhimin e risqeve, shkëmbimin e të dhënave dhe shërbimeve që do të kryhen përgjatë periudhës së mirëmbajtjes.*

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë: Autorizim Prodhuesi ose Distributori të autorizuar Autorizim Prodhuesi ose Distributori të Autorizuar për pajisjet Access Point dhe për licencat AP të infrastrukturës WI-FI, që do të furnizohen nëpërmjet kësaj kontrate.

Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi.

#### **Argumentimi:**

*Referuar nenit 77, pika 1, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:*

*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës...”*

*Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për furnizimet e kryera, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Në këtë kontekst, referuar natyrës dhe objektit të prokurimit, kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar bën të mundur sigurimin, cilësinë dhe standardin e mallrave të furnizuar, sipas parashikimeve të specifikimeve teknike dhe shërben si garanci në çfarëdo rasti anomalie përgjatë afatit të ekzekutimit të kontratës, si dhe garanton aktivizimin e shërbimeve të prodhuesit, sic janë ato të suportit dhe mbështetjes teknike e administrative.*

*Referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmive nga prodhuesi/ distributori i autorizuar, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues.*

*Ky kriter lidhet gjithashtu dhe me nevojën për garanci mbi eficientësinë dhe kapacitetet teknike të pajisjeve dhe licencave.*

**2.3.6** Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës si dhe për të garantuar suportin përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës dhe specifikimeve teknike, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar, që do të angazhohen në implementimin e kontratës, me kërkesat minimale si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për "ITIL Foundation" ose ekuivalent për menaxhimin e SLA dhe shërbimin e mirëmbajtjes.
- b) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel “CCNA” ose ekuivalente për network për të suportuar dhe mirëmbajtur zgjidhjen Switching.
- c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për sistemet e sigurisë së informacionit.
- d) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për të mirëmbajtur sisteme për teknologjinë wifi Ruckus ose ekuivalente.
- e) Të paktën 2 (dy) punonjës ose teknik të fushës, të pajisur me kartela të sigurimit teknik nga I.SH.T.I. ose nga institucione ekuivalente me të.

*Një punonjës mund të ketë edhe më shumë se një certifikim sipas kërkesave më sipër, por për cdo rast jo më shumë se dy të tillë.*

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Certifikata/ Transkriptet përkatëse për specialistët e kërkuar;
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik (emër mbiemër) profilin e punonjësve (certifikimet përkatëse) nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B;
- Listëpagesat sipas formularit eSig25 për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B.

Shënim: Kriteri 2.3.6 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentim:** Bazuar në nenin 40 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar) përcaktohet:

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”

a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për "ITIL Foundation" ose ekuivalent për menaxhimin e SLA dhe shërbimin e mirëmbajtjes.

**Argumentim:** Një certifikim ITIL është një set praktikash, kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të kontratës së autoritetit kontraktor. Kërkesa për certifikim ITIL ose ekuivalente, i garanton ideimin dhe konceptimin e shërbimeve IT të kontratës në mënyrë të menaxhueshme sipas standardeve ndërkombëtare të njohura, në gjithë ciklin e tyre, përfshirë këtu dhe shërbimet e mirëmbajtjes. Kjo kërkesë garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka në përbërjen aktuale të stafit të tij personel të kualifikuar që ndjek dhe mbikqyr projektet në nivel operacional bazuar mbi standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të menaxhimit të shërbimeve IT.

b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel “CCNA” ose ekuivalent për network për të suportuar dhe mirëmbajtur zgjidhjen Switching.

**Argumentim:** Plotësimi i kësaj kërkesë është garanci për Autoritetin Kontraktor që Operatori Ekonomik ka në përbërje të personelit të tij një punonjës të aftë për të realizuar shërbimet që lidhen me networking si vendosja, instalimi e konfigurimi i pajisjeve switch, për të suportuar dhe mirëmbajtur infrastrukturën. Planifikimi dhe kryerja e shërbimeve objekt kontrate kërkon aftësi dhe ekspertizë të përgjithshme në networking, pasi komponentët objekt kontrate, në mënyrë direkte apo indirekte lidhen me rrjetin e Autoritetit Kontraktor.

c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për sistemet e sigurisë së informacionit

**Argumentim :** Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor kërkon të vërtetojë që punonjësi i certifikuar për sistemet e sigurisë së informacionit, pjesë e stafit teknik të operatorit



ekonomik, ka aftësi të planifikojë, të udhëheqë, të raportojë dhe të auditojë menaxhimin e sigurisë së informacionit në funksion të sistemit elektronik që do të ndërtohet dhe që do të mirëmbahet, si dhe të garantojë që sistemi është konform standardeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, në të gjithë hallkat funksionale të tij dhe si i tillë mund të menaxhojë në mënyrë të sigurt informacionin. Prania e tij jep garanci për sigurinë e sistemit gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

- a) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për të mirëmbajtur sisteme për teknologjinë wifi Ruckus ose ekuivalente.

**Argumentim:** Duke qenë se projekti përfshin shërbime dhe suport për platformën dhe pajisjet ekzistuese të teknologjisë wifi Ruckus, kërkohen punonjës të certifikuar për të mirëmbajtur sisteme të kësaj teknologjie ose ekuivalente. Kërkesa për një punonjës të certifikuar sipas kërkesave të këtij kriteri shërbejnë për të demonstruar aftësinë e Operatorit Ekonomik për të ofruar shërbime suport kompetente, të specializuara dhe profesionale.

- b) Të paktën 2 (dy) punonjës ose teknik të fushës, të pajisur me dëshmi të sigurimit teknik nga I.SH.T.I. ose nga institucione ekuivalente me të

**Argument :** Kërkesa për 2 (dy) punonjës ose teknik të fushës, të pajisur me kartela të sigurimit teknik, është hartuar mbështetur në nenin 7 të ligjit nr. 13/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, ku citohet se:

“...Përdorimi i pajisjeve elektrike bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse...”

Kjo kërkesë është hartuar në përputhje me objektin dhe volumin e kontratës, në përputhje me termat e referencës së kontratës dhe specifikimeve teknike objekt kontrate.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të zotërojë licencë profesionale të shoqërisë, e vlefshme, për realizimin e objektit të kontratës, të lëshuar nga MPPT/MTI ose nga institucionet e autorizuara me ligj, me kategoritë e mëposhtme:

- NS 13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në Republikën e Shqipërisë. (Mbështetur në Rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në nr.42, datë 16.01.2008).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP; në nenin 40, pika 5/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për të realizuar objektin e kontratës. Kërkesa e mësipërme për licencim në mbështetje të kuadrit ligjor në fuqi, është në përputhje me natyrën ku ndërthuret furnizimi i mallrave me instalimet dhe vendosjen e tyre si dhe në përputhje me volumin e kontratës. Përcaktimi i kategorisë së licensave është bërë duke patur parasysh specifikimet

teknike, preventivin e volumet, larmishmërinë e zërave të punës (Instalime elektrike, instalime dhe mirembajtje rrjeti lan, fibre, etj.). Përcaktimi i nivelit të klasifikimit është vendosur (A) bazuar në vlerën e preventivit sipas zërave përkatës i cili nuk e kalon nivelin deri në 20 milion lekë, të përcaktuar.

**Shënim:** OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s'kualifikimi.
- Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Argumentim i specifikimeve teknike (termave të referencës):**

*Termet e referencës/ Specifikimet teknike, janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, si dhe informacionin specifik për shërbimet objekt kontrate, referuar termave të referencës, që përcaktojnë natyrën, objektin, qëllimin dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.*

*Qëllimi i këtij projekti është zgjerimi i hartës së ofrimit të shërbimit WiFi, nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës nevojshme për këtë qëllim, në hapësira të reja publike në qytetin e Tiranës, zgjerimi i infrastrukturës në ambientet ekzistuese nëse do të konsiderohet e nevojshme nga autoriteti kontraktor si dhe mirëmbajtja e pajisjeve, aksesorëve dhe të gjithë komponentëve që mundësojnë ofrimin e shërbimit, sipas kërkesave në këtë dokument.*

*Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Zhvillimi dhe Rritja e Kapaciteteve të Infrastrukturës për Ofrimin e Shërbimit Wifi në Ambientet Publike të Tiranës”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.*

**Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

- Dokumentat e tenderit
- Termat e referencës/ specifikimet teknike

**NJËSIA E PROKURIMIT**